



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Prijmje/Prudato Received/Delivery	16 - 03 2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Jednitca Org./Unit	SKIMS/SHUK	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix
	2743/2023		Sasia Kolicina Quantity
			114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.289/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.289/2023 të datës 01.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër XII-18 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Obiliqit i datës 17.01.2023, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.289/2023 e datës 01.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër: XII-18 i datës 17.01.2023 i Komisionit Disiplinor në Komunën e Obiliqit.

A r s y e t i m

Ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Komunën e Obiliqit, me datë 01.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil e cila është regjistruar me shenjën A.nr.289/2023 dhe numër protokoll:1176/2023, kundër Vendimit me numër XII-18 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Obiliqit i datës 17.01.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisionin Disiplinor me rastin e shqiptimi të masës disiplinore, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën e

Përgjithshme Administrative, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses si të bazuar, ndërsa të anulohet Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 17.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 13.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Obiliqit. Ndërsa me datën 06.03.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër te protokollit 1176/2023 të datës 01.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Vendimi i lëshuar nga Komisioni Disiplinor me numër XII-18 i datës 17.01.2023; Kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore me numër II-1813 i datës 12.12.2022; Kërkesa për qasje në dokumente publike e datës 06.12.2022; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar A.H i datës 09.01.2023; Procesverbal i seancës me numër XII-15 i datës 11.01.2023; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar A.H i datës 27.12.2022; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar A.H i datë 27.12.2022; Procesverbal i seancës i datës 27.12.2022; E-mail i dërguar nga A.H drejtuar A.M e datës 30.12.2022; E-mail i dërguar nga E.D drejtuar A.H i datës 27.12.2022; E-mail i dërguar nga E.D drejtuar A.D i datës 11.01.2023; E-mail i dërguar nga F.P drejtuar E.D i datës 19.12.2022; Komunikatë për media nga Asociacioni i Komunave të Kosovës; E-mail i dërguar nga A.H drejtuar B.M, etj i datës 05.09.2022; E-mailin i dërguar nga A.H drejtuar XH.G i datës 21.07.2022; Raporti Janar-Qershor i ankuesit; E-mailin i dërguar nga B.M dërguar B.G etj i datës 19.12.2022; Transparimetrin Komunal i përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës për periudhën Korrik-Dhjetor; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 13.02.2023; Përgjigja në ankesë e datës 06.03.2023; E-mail i dërguar nga L.H drejtuar KPMSHCK i datës 03.03.2023; Akt emërimi i ankuesit i datës 16.06.2016; Konkurs me numër II-251 i datës 16.04.2015; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 31.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 07.02.2022; E-mailin e dërguar nga B.G drejtuar B.M i datës 16.12.2022; E-mail i dërguar nga A.H drejtuar B.G i datës 16.12.2022; E-mail i dërguar nga B.G drejtuar E.D i datës 19.12.2022; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar E.H, etj i datës 04.01.2023 me korrespondencën e bashkangjitur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 16.06.2016 mban pozitën e punës "Zyrtar për Informim dhe marrëdhënie me publikun" në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Obiliqit, ndërsa Kryetari i Komunës së Obiliqit në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë ndaj të njëjtit përmes kërkesës me numër II-1813 të datës 23.12.2022, ka kërkuar inicimin e procedurës disiplinore nga Komisioni Disiplinor për shkelje disiplinore dhe atë për mos përmbushjen e detyrave të punës dhe mosrespektimin e afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave të cilat kanë sjell pasoja të rënda.

Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër XII/18 të datës 17.01.2023 ankuesit, kishte konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të përcaktuara me nenin 45 dhe nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe si rrjedhojë të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim nga 20% të pagës periudhë deri në një (1) muaj" me arsyetimin se ankuesi përmes e-mailit të datës 06.12.2022 ka pranuar kërkesën për qasje në dokumente publike

se bashku me pyetësorin lidhur me Transparimetrin Komunal për vitin 2022 nga Instituti Demokratik i Kosovës, ku është kërkuar përgjigje deri me datën 13.12.2022, ndërsa ankuesi duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 1 i Ligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike është dashur të përgjigjet brenda afatit prej 7 ditëve dhe rrjedhimisht i njëjti nuk ka respektuar afatin kohor për më tepër ka angazhuar zyrtarë tjerë të kabinetit të Kryetarit për të kthyer përgjigje tek me datë 16.12.2023 dhe si rrjedhojë e neglizhencës, Komisioni Disiplinorë ka vërtetuar se veprimi i ankuesit ka sjell pasoja në renditjen e Komunës së Obiliqit në raportet e KDI-së sa i përket transparencës, të cilat kanë ndikim të madh në shoqëri. Po ashtu, për katër takimet e organizuara për raportimin e performancës për vitin 2021, Komisioni Disiplinor ka vërtetuar se ankuesi ka munguar në dy prej tyre prej të cilave njëjën mungesë nuk e ka arsyetuar fare, ndërsa tjetrën e ka arsyetuar pesë ditë me vonesë, sikurse i njëjti lidhur me përmbushjen e detyrave të punës ka përgatitur vetëm pesë raporte javore dhe raportin gjashtë mujor Janar-Qershor me çka Komisioni Disiplinor ka konstatuar se ankuesi nuk i ka përmbushur plotësisht detyrat e punës sa i përket raportimit të rregullt, nga rrjedh se pretendimi i iniciuesit të procedurës ndaj ankuesit se i njëjti nuk raporton për përmbushjen e detyrave të punës është i bazuar.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore ndërlidhur më masën e shqiptuar disiplinore, ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik që përcakton se: *"1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore; dhe 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. Mos përmbushja e detyrave të punës"* dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore përmes Vendimit me numër XII/18 të datës 17.01.2023 ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, ngase ankuesi në cilësinë e Zyrtarit për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun sipas përkrahimit të detyrave të punës është i ngarkuar me detyrën: *"Siguron transparencë dhe qasje publike për punën e organeve të administratës komunale, të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjeve komunale duke u ofruar informata të qytetarëve dhe mediave"*, sikurse përcaktohet edhe në nenin 12 paragrafi 1 i Ligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike: *"1. Institucioni publik detyrohet që brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë"*, nga rrjedh se i njëjti nuk i ka përmbushur detyrat e punës sikurse dhe një çështje të tillë i njëjti e konfirmon edhe në seancën disiplinore të mbajtur me datë 11.01.2023 i cili potencon se pas këtij rasti ka filluar të ketë kujdes lidhur me trajtimin e kërkesave të tilla me qëllim që komuna të dal sa më mirë për vitin 2023, sikurse i njëjti me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill nuk ka arritur të dëshmojë me prova materiale se ka raportuar në mënyrë të rregullt tek udhëheqësi i drejtpërdrejt për përmbushje e detyrave të punës në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Obiliqit.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë pabazuar ndërsa ankesa e tij është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, kurse akti i kontestuar përmes kësaj ankese, gjegjësisht Vendimi me numër XII-18 i datës 17.01.2023 i Komisionit Disiplinor në Komunën e Obiliqit është akt administrativ i ligjshëm sikurse i njëjti i përmbush elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencat e përcaktuara me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-

114 për Zyrtarët Publik, ndërsa ka konstatuar saktë gjendjen faktike dhe bazën juridike pasi veprimi apo mosveprimi i ankuesit në rastin konkret paraqesin shkelje disiplinore për mos përmbushje të detyrave të punës sikurse është përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur i cili pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.289/2023

**Flakron Gashi**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Komunën e Obiliqit;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

